

Ş. XI. 1987

TDV İSAM
Kütüphanesi Arşivi
No ZE.2044

Sergili Ziyad,

Istanbul'a senin yanına misafir
gelmek için senin tarafından
yapılması icâh eden misafiret
davetiyesi ve taahhütnamesi
nümûnesi olarak üsûlen gereken
bir kopyeyi meffufen gönderiyorum.

Araya - buradan gidip gelenlerin
bu gerekli vesikasını ekseriyetle
isaret ettiğim ^{Fatih'deki} noter tanzimi ediyor
Sen de istersen aynı Noterde yaparsın,
Telefon et ona. Yoktur herhangi ahkâmın
bu noterde. Nasıl istersen.

Ancak bu meffuf kopye
mücibince olmak üzere.

Sihhat, iyilik duası ve candan

sevgilerimizle, Bayın T. T. K. E. N. E. M.

"Gönderdiğim
Haccları için (H. Aray
teknikle aldı) sat tekniği".

Feri Popullit
29.8.1987

PERSHENDETJE POPULLIT MIK TURK

*Curk milletinin Mustafa Kemal Atatürkün
"enaklılığı ile yaptıkları emval oluğu
Kurultayın sonuna kadar ilanı edilen Cumhuriyetin
esimdir. Vatanının vatanlılığıdır. Anadolunun
güçlü birliği ve birliğiyle.*

Sot populli turk është në festë. Ai kremton ditën e shpalljes së Republikës, të cilën e fitoi 64 vjet më parë, më 29 tetor 1923. Shpallja e Republikës ishte një fitore e madhe për popullin turk që u arrit nëpërmjet një lufte të gjatë e të vështirë. Pas Luftës së Parë Botërore, fuqitë imperialiste të Antantës ndërmorën një intervencion të hapur kundër Turqisë për ta copëtuar atë. Në këto momente të vështira populli turk u ngrit i gjithë në këmbë me armë në dorë dhe i shpartalloi planet imperialiste të Antantës. Në këto çaste kritike në krye të masave doli një nga bijtë më të shquar të popullit turk, Mustafa Qemal Atatürku, i cili jo vetëm e udhëhoqi luftën e popullit turk në fitore, por njëkohësisht e futi vendin në rrugën e përparimit dhe progresit. Mustafa Qemal Atatürku nderohet e respektohet jo vetëm nga populli turk, por edhe nga popujt e tjerë lidhshës në botë. Populli shqiptar e ka vlerësuar lart rolin e tij dhe ka një admirim e respekt të veçantë për këtë bir të shquar të popullit turk.

Në ditën e festës së tij kombëtare populli turk shikon me kërenari arritjet e tij në fushën e përparimit të ekonomisë e të kulturës kombëtare. Vitet e fundit një vëmendje e veçantë i është kushtuar investimeve në industri. Investime të mëdha janë bërë në industrinë energjetike, po ndërtohen hidrocentrale gjigande mbi lumin e Eufratit, në juglindje të vendit. Zhvillim të vrullshëm ka marrë industria mekanike, metalurgjike, kimike dhe ajo petrokimike. Turqia tashmë është e përmendur edhe për industrinë e saj tekstile, eksportet e së cilës janë të njohura. Arritje të ndjeshme janë shënuar edhe në bujqësi, frutikulturë etj.

Një interes i posaçëm tregohet për ruajtjen e zhvillimin e folklorit të pasur. Shumë ansamble folklorike turke janë shquar në festivalet e ndryshme ndërkombëtare dhe janë nderuar me çmime të ndryshme. Një vëmendje e veçantë në Turqi i është kushtuar kërkimeve arkeologjike. Pasojë e punës së kujdesëshme janë bërë zbulime të shumta arkeologjike të më se gjashtë qytetërimeve të lashta.

Populli shqiptar ka ushqyer dhe ushqen ndjenja të miqësisë për popullin turk. Midis RPS të Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë ekzis-

tojnë marrëdhënie miqësore, të cilat zhvillohen në frymën e bashkëpunimit e të fqinjësisë së mirë të bazuara në parimet e njohura që rregullojnë marrëdhëniet midis vendeve tona. Duke folur për miqësinë midis dy popujve e dy vendeve tona shoku Ramiz Alia ka theksuar se midis popullit shqiptar e popullit turk ka marrëdhënie të ngushta miqësore që kanë lidhje me të kaluarën e të sotmen e dy popujve e vendeve tona.


Zhvillimit të këtyre marrëdhënieve i kanë shërbyer shkëmbimet në fusha të ndryshme midis të dy vendeve. Vërehet me kënaqësi se gjatë këtij viti këto shkëmbime kanë qenë të shumta në fusha të ndryshme. Një delegacion i nivelit të lartë të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë vizitoi vendin tonë. Gjithashtu janë konkretizuar e nënshkruar një numër protokollesh e marrëveshesh në fushën e shkëmbimeve tekniko-shkencore, për transportin detar, shkëmbimet turistike, është nënshkruar protokollin e shkëmbimeve midis Universitetit «Enver Hoxha» të Tiranës dhe Universitetit të Ankarasë etj, të cilat do t'i japin një shtytje të mëtejshme marrëdhënieve të deritanishme. Gjithashtu vendi ynë ka marrë pjesë në shumë aktivitete të zhvilluara në Turqi si në fushën e kulturës, sportit, artit, panaireve tregtare etj., si dhe grupe të ndryshme turke të artit, kulturës, shkencës, etj kanë vizituar Shqipërinë.

Këto zhvillime të fundit midis të dy vendeve tona kanë krijuar mundësi për zgjerimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore midis të dy vendeve e të dy popujve tanë në të ardhmen. Në këtë kuadër, dhe më gjerë ky zhvillim i marrëdhënieve miqësore midis tyre kontribuon në forcimin e paqes e të sigurisë së vërtetë në Ballkan, në Evropë e më gjerë.

Me rastin e festës kombëtare të Turqisë, bashkë me urimet më të ngrohta e të përzemërta, populli shqiptar i shpreh edhe njëherë popullit mik turk bindjen dhe dëshirën se këto marrëdhënie miqësore që ekzistojnë do të forcohen edhe më shumë në të ardhmen në dobi të të dy vendeve tona, në të mirë të paqes e të sigurisë së vërtetë në Ballkan, në Evropë dhe kudo në botë.

LULZIM ÇOTA

Delegacioni i Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë vizitoi Shkodrën



(Foto: ATSH)

Dje delegacioni i Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë i kryesuar nga kryetari i saj Nexhmedin Karaduman dhe personat që e shoqërojnë bënë vizitë në qytetin e Shkodrës. Miqtë turq shkuan në ekspozitën kombëtare të kulturës popullore. Gjatë vizitës ata vlerësuan kujdesin që tregohet në Shqipëri për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës dhe të traditave të pasura të popullit tonë në këtë fushë. «Ekspozita që vizituam sot me pavionet e saj, tha ndër të tjera Nexhmedin Karaduman, përfaqëson në çdo aspekt kulturën e lashtë dhe

të re të popullit dhe shërben si burim frymëzimi për artistët e sotëm. Ajo është shumë interesante dhe tregon shumë bukur se sa të suksesshëm kanë qenë shqiptarët në ruajtjen e tipareve të artit të tyre popullor». Delegacioni turk vizitoi edhe uzinën e telave të bakrit. Ai u njoh atje me punën që bëjnë punëtorët e kësaj uzine për zgjerimin e kapaciteteve, rritjen e prodhimit dhe shtimin e artikujve të rinj. Gjithashtu Nexhmedin Karaduman dhe personat që e shoqërojnë bënë një vizitë në kalanë e lashtë të Rozafës.

Për nder të miqve të shquar nga Turqia kryetari i Kryesisë së Këshillit Popullor të rrethit Adem Golemi shtroi një drekë, në të cilën merrnin pjesë deputetët Muho Asllani, Terezina Marubi dhe shokë të tjerë.

Dreka kaloi në një atmosferë të ngrohtë e miqësore.


Në këto vizita delegacioni turk shoqërohej nga kryetari i kryesisë së Kuvendit Popullor Petro Dode, sekretari i Presidiumit të Kuvendit Popullor Sihat Tozaj dhe zëvendësministri i Punëve të Jashtme Muhamet Kapllani.

(ATSH)

Bashkimi
20. II. 1987

TDV ISAM
Kütüphanesi Arşivi
No 20.2044

SEKRETARI I PARE I KOMITETIT QENDROR TE PARTISE DHE KRYETAR I PRESIDIUMIT TE KUVENDIT POPULLOR, SHOKU RAMIZ ALIA, PRITI KRYETARIN E ASAMBLESE SE MADHE KOMBETARE TE REPUBLIKES SE TURQISE NEXHMEDIN KARADUMAN



(Foto: ATSH)

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë dhe kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë shoku Ramiz Alia priti dje paradite në Pallatin e Brigadave kryetarin e Asamblesë së Madhe Kombëtare të Republikës së Turqisë Nexhmedin Karaduman dhe pjesëtarët e tjerë të delegacionit të kryesuar prej tij.

Në pritje merrnin pjesë nënkryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor Rita Marko, kryetari i Kryesisë së Kuvendit Popullor Petro Dode, ministri i Punëve të Jashtme Reis Malile.

Ishin të pranishëm edhe ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i RPS të Shqipërisë në Turqi Gjylani Shehu dhe ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Turqisë në vendin tonë Bilal Shimshir.

Gëzohem që u takuam bashkë, i thotë shoku Ramiz Alia duke i uruar mirëseardhjen kryetarit të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë.

- Është edhe për ne kënaqësi dhe ndjehemi të lumtur që takohemi e bisedojmë me ju, iu përgjigj Nexhmedin Karaduman.

Në bisedë shoku Ramiz Alia

tha, ndërmjet të tjerash, se midis popullit shqiptar e popullit turk ka marrëdhënie të ngushta miqësore që kanë lidhje me të kaluarën e me të sotmen e dy popujve e vendeve tona. Ai theksoi se pavarësisht nga sistemet e ndryshme shoqërore të të dy vendeve marrëdhëniet e miqësisë e bashkëpunimit janë të mira dhe se ato janë zhvilluar dhe vazhdojnë të zhvillohen në të gjitha fushat. Por, vuri në dukje shoku Ramiz, mundësitë janë për zgjerimin e mëtejshëm të tyre, sidomos në fushat e tregtisë, bashkëpunimit tekniko - shkencor e të kulturës. Vizita që bëtë ju në vendin tonë, u tha ai miqve turq, do të kontribuojë në forcimin e këtyre marrëdhënieve.

Nga ana e tij Nexhmedin Karaduman vuri në dukje mikpritjen shumë të ngrohtë që iu bë delegacionit gjatë këtyre ditëve në Shqipëri dhe i transmetoi shokut Ramiz Alia urimet dhe përshëndetjet e Presidentit të Republikës së Turqisë zotit Kenan Evren. Ai tha se Shqipëria e Turqia janë dy vende miq që kanë midis tyre marrëdhënie vëllazërore, që janë të mbështetura në themele të shëndosha, në kontributin që kanë dhënë udhëheqësit e mëdhenj,

Mustafa Kemal Atatürk dhe Enver Hoxha.

Duke folur për përshtypjet e kësaj vizite ai tha se ne pamë me sytë tanë zhvillimin e përparimin e Shqipërisë dhe theksoi dëshirën për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve.

Shoku Ramiz Alia, pasi u tregoi miqve për luftën e përpjekjet e popullit tonë për një jetë të lirë e të lumtur, për zhvillimin kulturor e emancipimin shoqëror të jetës së vendit, dhe për ndjenjat e miqësisë vëllazërore me popullin turk, tha se edhe me shtetet e tjerë, sidomos me fqinjët, Shqipëria dëshiron që të jetë në paqe e miqësi, mbi bazën e respektimit të lirisë e pavarësisë kombëtare. Gjithashtu ai shprehu përshëndetjet për Presidentin e Turqisë, zotin Kenan Evren dhe uroi që në të ardhmen marrëdhëniet e miqësisë e të bashkëpunimit midis Shqipërisë e Turqisë të përparojnë më tej në të mirë të dy popujve e vendeve tona, në dobi të paqes e stabilitetit në rajonin e Ballkanit.

Pritja kaloi në një atmosferë të përzemërt e miqësore.

(ATSH)

Delegacioni i Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë, i kryesuar nga kryetari i saj Nexhmedin Karaduman, u largua nga vendi ynë

Pas një vizite zyrtare e miqësore në Shqipëri, dje u largua nga vendi ynë delegacioni i Asamblesë së Madhe Kombëtare të Republikës së Turqisë, i kryesuar nga kryetari i saj, Nexhmedin Karaduman, me bashkëshorten, si dhe personalitetet që e shoqërojnë.

Në aeroportin e Rinasit për të përcellë miqtë e shquar nga Turqia kishin dalë kryetari i Krye-

sisë së Kuvendit Popullor, Petro Dode, nënkryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Rita Marko, zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, Besnik Bekteshi, anëtarë të Presidiumit të Kuvendit Popullor e të Qeverisë, deputetë e funksionarë të dikastereve qendrore. Ata u përshëndetën ngrohtësisht dhe iu uruan rrugë të mbarë kryetarit të Asamblesë së Madhe Ko-

mbëtare të Turqisë, Nexhmedin Karaduman dhe pjesëtarëve të tjerë të delegacionit.

Ndodheshin gjithashtu ambasadori i jashtëzakonshëm e fuqiplotë i RPS të Shqipërisë në Turqi, Gjylani Shehu, dhe ambasadori i jashtëzakonshëm e fuqiplotë i Republikës së Turqisë në vendin tonë Bilal Shimshir.

(ATSH)

20. 7. 1989

SEKRETARI I PARË I KOMITETIT QENDROR TË PARTISE DHE KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR SHOKU RAMIZ ALIA PRITI KRYETARIN E ASAMBLESE SE MADHE KOMBETARE TE REPUBLIKES SE TURQISE NEXHMEDIN KARADUMAN



Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë dhe Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shoku Ramiz Alia priti dje paradite në Pallatin e Brigadave kryetarin e Asamblesë së Madhe Kombëtare të Republikës së Turqisë, Nexhmedin Karaduman dhe pjesëtarët e tjerë të delegacionit të kryesuar prej tij.

Në pritje merrnin pjesë nënkryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor Rita Marko, kryetari i Kryesisë së Kuvendit Popullor Petro Dode, ministri i Punëve të Jashtme Reis Malile. Ishin të pranishëm edhe ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplojë i RPS të Shqipërisë në Turqi Gjylani Shehu dhe ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplojë i Republikës së Turqisë në vendin tonë Bilal Shimshir.

Duke i urrear mirëseardhjen kryetarit të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë shoku Ramiz Alia i thotë se gëzohem që u takuam bashkë.

Është edhe për neve kënaqësi dhe ndjehemi të lumtur që takohemi e bisedojmë me ju, iu përgjigj Nexhmedin Karaduman.

Në bisedë shoku Ramiz

Alia tha ndërmjet të tjerash se midis popullit shqiptar e popullit turk ka marrëdhënie të ngushta miqësore që kanë lidhje me të kaluarën e me të sotmen e dy popujve e vendeve tona. Ai theksoi se pavarësisht nga sistemet e ndryshme shoqërore të të dy vendeve, marrëdhëniet e miqësisë e të bashkëpunimit janë të mira dhe se ato janë zhvilluar dhe vazhdojnë të zhvillohen në të gjitha fushat. Por, vuri në dukje shoku Ramiz, mundësitë janë për zgjerimin e mëtejshëm të tyre, sidomos në fushat e tregtisë, bashkëpunimit tekniko-shkencor e të kulturës. Vizita që bëtë ju në vendin tonë, u tha ai miqve turq, do të kontribuojë në forcimin e këtyre marrëdhënieve.

Nga ana e tij Nexhmedin Karaduman vuri në dukje mikpritjen shumë të ngrohtë që iu bë delegacionit gjatë këtyre ditëve në Shqipëri dhe i transmetoi sho'kut Ramiz Alia urimet dhe përshëndetjet e Presidentit të Republikës së Turqisë, zotit Kenan Evren. Ai tha se Shqipëria e Turqia janë dy vende miq që kanë midis tyre marrëdhënie vëllazërore, që janë të mbështetura në themele të shëndosha, në kontributin që kanë dhënë

udhëheqësit e mëdhenj, Mustafa Kemal Atatürk dhe Enver Hoxha.

Duke folur për përshtypjet e kësaj vizite ai tha se në pamë me sytë tanë zhvillimin e përparimin e Shqipërisë dhe theksoi dëshirën për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve.

Shoku Ramiz Alia, pasi u tregoi miqve për luftën e përpjekjet e popullit tonë për një jetë të lirë e të lumtur, për zhvillimin kulturor e emancipimin shoqëror të jetës së vendit dhe për ndjenjat e miqësisë vëllazërore me popullin turk, tha se edhe me shtetet e tjerë, sidomos me fqinjët, Shqipëria dëshiron që të jetojë në paqe e miqësi, mbi bazën e respektimit të lirisë e pavarësisë kombëtare. Gjithashtu ai shprehu përshëndetjet për Presidentin e Turqisë zotin Kenan Evren dhe uroi që në të ardhmen marrëdhëniet e miqësisë e të bashkëpunimit midis Shqipërisë e Turqisë të përparojnë më tej në të mirë të dy popujve e vendeve tona, në dobi të paqes e stabilitetit në rajonin e Ballkanit.

Pritja kaloi në një atmosferë të përzemërt e miqësore. (ATSH)

TÜRKİYE CUMHURİYETİ

TAAHÜT NÂME

Hâlen Arnautlukta bulunan aşağıda açık kimlikleriyle konut adresleri ve akrabalık derecelerim yazılı Arnautluk uyruklu yakınlarımın bir aylığına misafir olarak Türkiye'ye yanıma davet ediyorum. Kendilerinin Türkiye'ye misafir olarak gelebilmeleri için ilgili Arnautluk makamlarınca gerekli iznin verilmesi halinde vizelerinin ve davet ettiğim yakınlarımla vize müddetlerinin sonunda kendilerini Arnautlukta geri göndereceğimi, Türkiye'de misafir kalacakları süre içinde, konut, yiyecek ve diğer tüm masraflarıyla, Türkiye Hudutlarına içindeki geliş ve dönüş giderlerini karşılayacağımı, Türkiye'ye herhangi zamanda gelirlerse gelsinler kabul edeceğimi taahhüd eder ve yüklenirim.

DAVET ETTİĞİM YAKINLARIMIN ARNAUTLUKTAKİ ADRESLERİ:

Arnautluk'da (Albania) Gërani şehrinde,
Lagji: №5, Bulv. Konferenta Pezës,
№167, iki katlı müstakil Evin
üst katında mukim: MÿKERREM JANINA

Ad ve Soyadları:

Baba adı: AZMI
Soyadı: JANINA
ANA ADI: LALINUR
Doğum yeri: İSTANBUL
Doğum tarihi: 1890
Akrabalık derecesi: Dayım.

2) Te Dayımın eşi:
Adı ve soyadı: BEATRİÇE JANINA
Baba adı: Zihni
Ana adı: Semiha
Doğum yeri: Gërana
Doğum tarihi: 1943
Akrabalık derecesi: Dayımın karısı

T. C.

ADALET BAKALIĞI

İSTANBUL
YIRMİBEŞİNCİ
NOTERİ

ERKAN VARDAR

Skopje Cadd.,
Eşpalloğlu Apt.
№ 82/1, FATİH
İst.

Tel.: 521 67 50
525 91 06
X

TDV İSAM
Kütüphanesi Arşivi
No ZE.2044

Taahhüt eden:

EİYAD EBÜZZİYA

adresi:

Kadıköy İlçesi,
Yağurtçu Park Cadd.,
52/17 numaralı yerde.

{ve birde fotoğraf
yapıştırılarak